



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_101_2008
Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_78_04_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_78_04_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

PJESËRISHT TË PRANOHET ankesa e konsumatorit Sadri Tafolli (shifra e konsumatorit në KEK: DPZ – 9013340) nga fshati Shirokë, Komuna e Therandës, për arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së të datës 15 maj 2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 11 maj 2007, lidhur me bartjen e borxhit për energji elektrike nga qiramarrësi i mëparshëm Besim Ajazi.
2. Konsumatori Sadri Tafolli në kërkesën e tij ka kërkuar që të lirohet nga borxhi për energji elektrike i krijuar nga Besim Ajazi, i cili ka qenë shfrytëzues i lokalit afarist me një kontratë qiramarrjeje në periudhën 01 mars 2004 deri me 01 mars 2006
Provë: Kontratë mbi qiranë e datës 22 mars 2004.
3. Besim Ajazi i cili ka shfrytëzuar lokalit afarist sipas kontratës me qiradhënësin, me datë 02 korrik 2004 ka nënshkruar me KEK-un kontratë për rregullimin e borxhit për energjinë elektrike prej datës 01 mars 2004 deri me datën e nënshkrimit të kontratës për rregullimin e borxhit 02 korrik 2004. Me këtë kontratë Besim Ajazi ka marrë obligim për kryerjen e obligimeve financiare ndaj KEK-ut për energjinë e konsumuar prej datës së marrjes së lokalit me qira 01 mars 2004.
Provë: Kontrata e rregullimit të borxhit e datës 02 korrik 2005.



4. KEK-u ka bërë kontratë me Besim Ajazin në shifër të konsumatorit Sadri Tafolli në bazë të kontratës për qiramarrje/dhënie në mes të këtyre dy palëve, me këtë rast KEK-u ka bërë tri shkelje të procedurave të veta interne:
 - 4.1 Ka bërë kontratë për rregullim të borxhit pa e përfshirë tërë borxhin e shifrës së konsumatorit Sadri Tafolli (1438,99 €), por vetëm pjesën për të cilën ka marrë obligim Besim Ajazi (475,00 €).
 - 4.2 Ka bërë kontratë pa kërkuar pagesën fillestare prej Besim Ajazit në vlerë € 100.00 + €11.00, por këtë ngarkesë e ka bartë në kartelë si ngarkesë për konsumatorin
 - 4.3 E ka ndërruar emrin e bartësit të shifrës dhe njehsorit vetëm në bazë të kontratës në mes të palëve - të pavërtetuar në gjykatë.

Provë: Kontrata për rregullimin e borxhit e datës 02 korrik 2005, kartela e transaksioneve të konsumatorit, faturat e konsumatorit, kontrata për shërbimet e energjisë me Besim Ajazin.
5. Gjatë periudhës të mbajtjes së lokalit me qira, Besim Ajazi ka bërë shpenzim të energjisë në vlerë 1309.58 € (përfshirë këtu dy njoftime për shkyçje nga 11.5 €, dhe taksën për shkyçje 115 € të datës 22 dhjetor 2005). Besim Ajazi gjatë periudhës së mbajtjes së lokalit në emër të tij ka bërë gjithsejtë pagesa në KEK në vlerë 580 €. Besim Ajazi i ka mbetur borxh KEK-ut në vlerë 729.58 €.

Provë: Kartela e transaksioneve të konsumatorit
6. Me datë 11 maj 2007 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë pa bërë analiza të duhura e ka refuzuar ankesën e konsumatorit duke u thirrur në atë se element identifikues i një konsumatori është shifra e tij, numri i njehsorit, adresa dhe emri i konsumatorit, duke mos marrë parasysh marrëdhënien kontraktuale që KEK-u ka bërë me Besim Ajazin.

Provë: Përgjigja e KEK Sh.A e datës 11 maj 2007.
7. DMK e ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori i **rekomandon** Bordit të ZRRE-së që **pjesërisht të pranohet** ankesa e konsumatorit dhe që KEK-u të ndërmerr këto veprime:
 - 7.1 Klientin Besim Ajazi ta ndjekë me procedura gjyqësore për mos pagesën e borxhit prej 729.58 € (sipas kontratës për rregullimin e borxhit), apo përmes bartjes së borxhit në ndonjë kartelë të re të konsumatorit (nëse është i regjistruar në KEK).
 - 7.2 Konsumatori Sadri Tafolli të shkarkohet nga kartela e tij për vlerën 729.58 € dhe të kërkohet pagesa e borxhit të mbetur.
 - 7.3 Mos të lejohet regjistrimi i ndonjë klienti tjetër në këtë shifër të konsumatorit pa u paguar borxhi i mbetur dhe pa dëshmi për kontratë për qiramarrje/dhënie të vërtetuar në Gjykatë.
 - 7.4 Të faturohet ky lokal afaristë (kjo shifër) në emër të pronarit Sadri Tafolli, për aq kohë sa nuk kemi ndonjë kontratë sipas pikës 3.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që pjesërisht të pranojë ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në rekomandimin e DMK në ZRRE.



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar